Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 17 shkurt 2012

Lënda nr. 11/08

Dragan PRELEVIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 17 shkurt 2012,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Marek NOWICKI, kryesues
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa i është paraqitur Panelit më 5 maj 2008 dhe është regjistruar me po të njëjtën datë. Ankuesi përfaqësohet nga zyra e avokaturës "Aleksiq, Mushiqki dhe bashkëpunëtorët", nga Novi Sadi, Republika e Serbisë.

2. Më 16 maj 2008, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesi. Nuk është pranuar asnjë përgjigje për këtë kërkesë. Më 6 qershor 2008, Paneli e ka përsëritur kërkesën e tij. Përgjigja është pranuar më 31 korrik 2008.

3. Më 21 korrik 2008 dhe 17 nëntor 2008, Paneli kërkoi sqarime shtesë nga ankuesi. Përgjigjet nga ankuesi u pranuan më 19 nëntor 2008 dhe 19 janar 2009.

4. Më 22 maj 2009, Paneli kërkoi informata dhe qartësime shtesë nga ankuesi. Një përgjigje është pranuar më 27 korrik 2009.

5. Më 1 shkurt 2010, Paneli për rastin e informoi Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e rastit. PSSP u përgjigj me letrën e datës 23 prill 2010.

6. Më 22 shtator 2010, përgjigja e PSSP-së iu dërgua ankuesit për dhënien e komenteve. Përgjigja e ankuesit është pranuar nga Paneli më 18 nëntor 2010.

7. Më 16 dhjetor 2010, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

8. Më 20 dhjetor 2010, për vendimin u informua PSSP-ja lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e ankesës. Më 3 maj 2011, PSSP i ofroi Panelit një përgjigje të përkohshme. Më 25 korrik 2011, PSSP i ofroi komentet mbi bazueshmërinë e ankesës.

II. FAKTET

9. Ankuesi është ish-banor i Kosovës, i cili aktualisht jeton në Serbi. Ai është pronar i një banese në Prishtinë, ku ka jetuar deri në qershor të vitit 1999, kur u largua nga Kosova për shkaqe sigurie.

10. Më 22 qershor 1999, ai lidhi një kontratë me z. B.M, duke i dhënë këtij të fundit të drejtën për shfrytëzimin e banesës, duke përfshirë mobilet dhe pajisjet, deri sa ky të kthehet dhe pa i paguar asnjë qira ankuesit. Megjithatë, kontrata parashihte që shfrytëzuesi obligohet t'i paguajë të gjitha shpenzimet e shërbimeve komunale, duke filluar nga dita e vendosjes së tij në banesë. Ankuesi më vonë kuptoi se banesa e tij ishte dëmtuar, mobilet dhe pajisjet ishin marrë, dhe se asnjë qira apo faturë e shërbimeve komunale nuk ishte paguar. Banesa ishte zënë nga z. B.M deri në fund të shtatorit 2005, kur ai është nxjerrë jashtë saj nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB).

11. Më 4 qershor 2004, ankuesi parashtroi padi për dëmet që i janë bërë në banesë, si dhe për qiranë dhe shërbimet komunale të papaguara, pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës përmes Gjykatës Komunale të Novi Sadit, Serbi, kundër z. B.M., Komunës së Prishtinës dhe Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ), përmes së cilës kërkon kompensim prej 20,000 eurosh. Në fakt, Gjykata Komunale e Prishtinës e ka pranuar padinë më 30 gusht 2004.

12. Pasi që nuk mori asnjë përgjigje nga Gjykata Komunale, më 28 prill 2006 ankuesi përgatiti një padi tjetër, që në përmbajtje ishte e njëjtë me atë të vitit 2004, dhe prapë e paraqiti atë në Gjykatën Komunale të Prishtinës, përmes Gjykatës Komunale të Nishit.

13. Në atë kohë z. Preleviq iu ankua Panelit për atë se Gjykata Komunale nuk e kishte kontaktuar atë, dhe asnjë seancë nuk ishte caktuar, për asnjërën padi.

14. Përafërsisht 17,000 padi për kompensime janë paraqitur në vitin 2004 pranë gjykatave të Kosovës, shumica dërrmuese e këtyre nga serbët e Kosovës, të cilët, për shkak të armiqësive, i kishin lënë shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe prona e të cilëve ishte dëmtuar dhe shkatërruar më vonë. Me synimin për të përmbushur afatin kohor pesëvjeçar sipas ligjit për

dorëzimin e padive civile për kompensim, këta paditës dorëzuan paditë e tyre rreth datës së njëjtë në vitin 2004. Paditë ishin të drejtuara kundër kombinimit UNMIK,KFOR, IPVQ dhe komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (më tej PKDNJ), *Millogoriq dhe të tjerët*, lëndët nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendimi i 24 marsit 2010, § 1; për bazën ligjore në të cilën paditësit e bazuan padinë e tyre, shih mendimin e njëjtë, § 5).

15. Për sa u përket këtyre rasteve, drejtori i Departamentit të Drejtësisë i UNMIK-ut (DD) u dërgoi një letër të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe rajonale dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, më 26 gusht 2004. Në letër, drejtori i DD-së përmendi që "mbi 14,000" padi të tilla janë paraqitur. Ai iu referua "problemeve që një vërshim aq i madh i padive do t'u shkaktojë gjykatave", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos parashihet në orar derisa të përcaktohet së bashku më së miri koha e duhur për të kryer shqyrtimin e këtyre rasteve" (për tekstin e plotë të letrës, shih *Millogoriq dhe të tjerët* mendimi, përmendur në § 14 më lart, në § 6).

16. Ankesa e ankuesit, edhe pse nuk bën pjesë në këtë kategori pasi që ajo i drejtohet edhe një personi të njohur me emër, është klasifikuar si e tillë dhe prandaj i është nënshtruar ndikimit nga udhëzimi i mësipërm i DD-së.

17. Më 15 nëntor 2005, DD-ja u kërkoi gjykatave që të fillojnë me shqyrtimin e padive për dëmet e shkaktuara nga personat e zakonshëm të identifikuar dhe dëmet e shkaktuara prej tetorit të vitit 2000, duke pasur parasysh që "pengesat për shqyrtimin efikas të këtyre rasteve" nuk ekzistonin më. Paditë e ndërlidhura me ngjarjet që ndodhën para tetorit të vitit 2000 nuk preken nga kjo letër.

18. Më 28 shtator 2008, drejtori i DD-së këshilloi gjykatat që rastet, të cilat nuk janë futur në orar për shqyrtim sipas kërkesës së 26 gushtit 2004, tani duhet të shqyrtohen.

19. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

III. ANKESA

20. Duke pasur në konsideratë shpalljen e ankesës të pranueshme, ankuesi në esencë pretendon që procedura lidhur me ankesën e tij për dëmet mbi pronën e tij ishte pezulluar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, duke bërë kështu të pamundur për atë që të ketë vendim për padinë e tij, që përbën shkelje të së drejtës së tij për të pasur qasje në një gjykatë sipas nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Ai gjithashtu ankohet që, si rezultat i këtij pezullimi, procedimi nuk ka përfunduar brenda një afati të arsyeshëm, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ-s.

IV. LIGJI

21. Në përgjigjen e tij mbi bazueshmërinë e ankesës në fjalë, PSSP ngrit argumente lidhur me specifikat e këtij rasti dhe i përsërit argumentet e dhëna në përgjigje ndaj bazueshmërisë së lëndës *Millogoriq dhe të tjerët* (përmendur në § 14 më lart).

22. Sa i përket këtij rasti, PSSP-ja në veçanti konteston vërtetësinë e vulës së pranimit, në padinë e parë të datës 4 qershor 2004, duke argumentuar se rasti ka mundur të jetë marrë nga një gjykatë "paralele", që funksiononte nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Serbisë.

23. Paneli konstaton që, sipas informatave të marra nga Zyra ndërlidhëse e gjykatave të Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës (më 3 gusht 2011), padia e ankuesit në fakt ishte paraqitur pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës, më 30 gusht 2004. Kryetari i Gjykatës Komunale të Prishtinës konfirmoi, më 23 nëntor 2011, që lënda është në Gjykatë dhe se ende është në zhvillim e sipër për t'u zgjidhur.

24. PSSP-ja gjithashtu argumenton që ai njësoj dyshon që padia në vitin 2006 është paraqitur si duhet në Gjykatën Komunale të Prishtinës.

25. Lidhur me këtë Paneli thekson se padia e dytë nga viti 2006 është e njëjtë për nga përmbajtja sikurse ajo e vitit 2004, dhe qoftë e parashtruar si duhet ose jo në Gjykatën Komunale, baza esenciale e ankesës nuk ndryshon pranë Panelit. Prandaj, Paneli konsideron se nuk ka nevojë që të shqyrtohet kjo çështje.

26. Paneli thekson se rastet e ankuesve ngritin çështje, përmbajtja e të cilëve tashmë i është paraqitur Panelit nga ankues të tjerë. Paneli rikujton që në rastet e bashkuara p.sh. në atë të *Millogoriq dhe të tjerët* (përmendur në § 14 më lart), ai ka shqyrtuar ankesat e pesë ankuesve, të cilët gjithashtu kanë qenë pronarë të pronave të paluajtshme në Kosovë. Në vitin 1999, duke pasur frikë nga armiqësitë, edhe ata ikën nga shtëpitë e tyre në Kosovë. Prona e tyre u dëmtua ose u shkatërrua gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999, pas hyrjes së UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë. Këta ankues kanë paraqitur padi gjithashtu në vitin 2004 pranë gjykatave komunale përkatëse kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe IPVQ-ve dhe komunave përkatëse, me të cilat kërkonin kompensim për dëmin që u ishte shkaktuar pronave të tyre. Ata as nuk ishin kontaktuar nga ana e gjykatave dhe as nuk ishin caktuar seanca, për shkak të intervenimit të lartpërmendur nga DD, që pezulloi procedimet gjyqësore nga gushti i vitit 2004 deri në shtator të vitit 2008.

27. Në rastin *Millogoriq* Paneli konstatoi se "fakti që, për një kohë të gjatë, ankuesit u penguan që t'i kenë vendimet nga gjykatat për ankesat e tyre si rrjedhojë e ndërhyrjes së DD-së, përbënte shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së", më konkretisht të drejtës së tyre për të pasur qasje në një gjykatë (PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët*, përmendur në § 14 më lart, në § 46). Paneli më tej konstatoi se "nuk [ishte] e nevojshme që të shqyrtohet ndaras çështja e kohëzgjatjes së procedimeve" (mendimi i njëjtë, në § 48).

28. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja i përsërit vërejtjet e tij të dhëna lidhur me bazueshmërinë e lëndës së *Millogoriq dhe të tjerët.*

29. PSSP-ja argumenton për sa i përket bazueshmërisë në rastin *Millogoriq dhe të tjerët*, mes tjerash, që kërkesa e UNMIK-ut për pezullimin e procedurave duhet të konsiderohet se ka pasur një qëllim të arsyeshëm, dhe që në rrethanat e Kosovës së pas konfliktit dhe sistemin gjyqësor të saj në progres, pezullimi i përkohshëm ishte mënyra e vetme që UNMIK-u të merrej me situatën përjashtuese me të cilën ballafaqohej sistemi gjyqësor i Kosovës, e që ishte shkaktuar nga parashtrimi i numrit të madh të padive për kompensim. PSSP-ja gjithashtu argumenton që ekzistonte një përpjesëtueshmëri e arsyeshme në mes të mjeteve të angazhuara dhe qëllimit që synohej të arrihej, për shkak se një bilanc i drejtë kishte ngecur në mes të kërkesave ndërmjet interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve. Sipas PSSP-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet duke marrë parasysh rrethanat e caktuara të rastit dhe GJEDNJ-ja zbaton tri kritere në veçanti: sjellja e autoriteteve gjyqësore, kompleksiteti i rastit, dhe sjellja e ankuesit. Vetëm vonesat që i atribuohen

shtetit përbëjnë shkelje të kërkesës për afat të arsyeshëm. PSSP-ja analizon në hollësi zbatimin e tri kritereve të mësipërme në kontekstin e Kosovës dhe pasi që ato kanë të bëjnë me ankuesit.

30. Sa i përket sjelljes së ankuesve, PSSP-ja argumenton në rastin *Millogoriq* që shumica prej tyre nuk kanë paraqitur asnjë dëshmi për të treguar që ata në ndonjë mënyrë ndonjëherë kanë pyetur sa i përket vazhdimit të rasteve të tyre, ose që janë ankuar se rastet e tyre nuk janë duke përparuar dhe se duhet të përparojnë qoftë në gjykatat vendore në Kosovë, qoftë në DD ose ndonjë organ tjetër të UNMIK-ut ose IPVQ-ve, duke përfshirë zyrat ndërlidhëse të gjykatave. Ankuesit nuk janë ankuar as tek EULEX-i pas vendosjes së tij në Kosovë, në dhjetor të vitit 2008. PSSP-ja gjithashtu argumenton që disa nga ankuesit nuk kanë paraqitur të kenë marrë ndonjë hap për rimarrjen e pronave të tyre pas vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB), që është marrë në mes të qershorit 2003 dhe tetorit 2008.

31. Sa i përket këtyre argumenteve, të dhëna lidhur me bazueshmërinë e lëndës së *Millogoriq dhe të tjerët* (përmendur në § 14 më lart), Paneli rikujton që ai tashmë i ka konsideruar dhe i ka refuzuar këto argumente në lëndët e *Millogoriq dhe të tjerët* në *Laliq dhe të tjerët* (PKDNJ, lëndët numër. 30/08 dhe të tjerët, mendimi i 13 majit 2011, § 21) dhe në *Mlladenoviq dhe të tjerët* (PKDNJ, lëndët numër 172/09 dhe të tjerët, mendimi i 16 dhjetorit 2011, § 22). Paneli ka konstatuar se është e vërtetë që karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë përkatëse duhet të merren parasysh siç duhet sa i përket një numri të situatave, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si justifikim për mos zbatimin në tërësi të standardeve lidhur me të drejtat e njeriut, të cilat janë përfshirë sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut (*Millogoriq dhe të tjerët*, § 44; *Laliq dhe të tjerët*, § 22; *Mlladenoviq dhe të tjerët*, § 24).

32. Paneli nuk sheh ndonjë arsye që të heqë dorë nga këto konstatime në lëndët *Millogoriq dhe të tjerët*, *Laliq dhe të tjerët*, dhe *Mlladenoviq dhe të tjerët.*

33. Megjithatë, në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës në fjalë, PSSP-ja po ashtu argumenton që Paneli nuk i ka trajtuar qartë politikat e UNMIK-ut për balancimin e prioriteteve konkurruese për menaxhimin e rasteve në përpjekje për të reduktuar rrezikun e vonesave për përdoruesit e tjerë të gjykatës, duke kërkuar opsione tjera për trajtimin e ankesave.

34. Paneli thekson se në fakt nuk janë gjetur opsione të tjera dhe se rastet, të cilat nuk janë caktuar sipas udhëzimeve të DD-së, më vonë është mundësuar që të trajtohen (shih §§ 17 dhe 18 më lart).

35. Në vazhdim, Paneli sjell ndërmend që në disa raste Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi shkelje të së drejtës së ankuesit që të ketë qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, pasi që mundësia për të pasur vendim gjykate për paditë e tyre ishte pezulluar për një kohë të gjatë si rezultat i intervenimit të legjislaturës (shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *Kutiq kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, vendimi i gjykatës, 1 mars 2002, *KEDNJ*, 2002-II, § 31, GJEDNJ, *Açimoviq kundër Kroacisë*, nr. 61237/00, vendimi i gjykatës, 9 janar 2003; GJEDNJ, *Multiplex kundër Kroacisë* nr. 58112/00, vendimi i gjykatës, 10 korrik 2003).

36. Lidhur me argumentin e PSSP-së që ankuesi nuk ka pyetur rreth shqyrtimit të rastit të tij para gjykatave përkatëse, qoftë para vendosjes së EULEX-it në dhjetor të vitit 2008 ose pas kësaj, Paneli tashmë i ka refuzuar këto argumente në rastin *Mlladenoviq dhe të tjerët*. Ai konstatoi se ankuesit nuk mund të fajësohen që nuk kanë parashtruar pyetje pranë gjykatave përkatëse lidhur me progresin në lëndët e tyre (*Mlladenoviq dhe të tjerët*, në § 31 më lart, në §26). Përveç kësaj, sa i përket argumentit që ankuesit nuk kanë parashtruar pyetje pranë EULEX-it rreth progresit në lëndët e tyre, Paneli ka konstatuar që kjo çështje nuk kishte rëndësi sa i përket shqyrtimit të ankesave, pasi që situata pas dhjetorit 2008 bie në çdo rast jashtë përgjegjësisë së UNMIK-ut (*Mlladenoviq dhe të tjerët*, § 26)

37. Paneli nuk sheh ndonjë arsye që të heqë dorë nga konstatimet e tij mbi këto çështje të bëra në rastin *Mlladenoviq dhe të tjerët*.

38. Përveç kësaj, PSSP-ja mendon se nga padia e ankuesit e vitit 2004 apo 2006 është e paqartë se kur në fakt është shkaktuar dëmtimi i pronës. Ai më tej argumenton se nëse dëmi ka ndodhur diku në vitin 1999, atëherë afati i padisë së vitit 2006 do të kishte përfunduar.

39. Paneli tashmë ka diskutuar rreth çështjes së padisë së vitit 2006 (shih §§ 24-25 më lart), dhe konstaton se kjo çështje nuk ka nevojë të shqyrtohet më.

40. Në fund, PSSP-ja argumenton që nëse padia e vitit 2004 në fakt ishte paraqitur si duhet në Gjykatën Komunale të Prishtinës, ajo do të ishte refuzuar nga gjykata duke u bazuar në atë se IPVQ-ve dhe komunave u mungon "legjitimiteti pasiv". PSSP lidhur me këtë i referohet një vendimi të Gjykatës Komunale të Deçanit në rastin *Stana Stioviq kundër IPVQ-ve, Komunës së Deçanit, UNMIK-ut dhe KFOR-it*, më 20 maj 2011.

41. Paneli thekson se vendimi të cilit i referohet PSSP-ja, ka të bëjë me një situatë të ngjashme me atë në ankesën pranë tij. Megjithatë, ky argument nuk ka rëndësi për vlerësimin e dështimit të pretenduar të Gjykatës Komunale të Prishtinës për të vendosur, brenda një afati të arsyeshëm, mbi bazueshmërinë e padisë pranë saj. Prandaj, Paneli konsideron që ky argument nuk është relevant për përcaktimin e ankesës në fjalë.

42. Duke i pasur parasysh ato që u thanë më lart, Paneli konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, lidhur me pamundësinë e ankuesve që t'i kenë vendimet e gjykatave për paditë e tyre, dhe se nuk është e nevojshme që çështja e kohëzgjatjes së procedurave të shqyrtohet ndaras.

V. REKOMANDIMET

43. Në dritën e gjetjeve të Panelit në këtë rast, Paneli mendon se është e nevojshme ndonjë formë e dëmshpërblimit.

44. Do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i ndalë shkeljet e gjetura dhe t'i korrigjojë aq sa është e mundshme efektet nga kjo. Megjithatë, siç ka theksuar Paneli më lart, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me administrimin e drejtësisë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen përsipër nga EULEX-i të kontrollit të plotë operacional në fushën e zbatimit të ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozitë të marrë masa që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në procedurat që janë në zhvillim e sipër para gjykatave komunale.

45. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për t'i korrigjuar aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës. Në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në situatat me juridiksion të kufizuar të shtetit, Paneli mendon që UNMIK-u duhet të bëjë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion të vet *vis-à-vis* autoriteteve të Kosovës, të marrë garanci që rasti i paraqitur nga ankuesi do të shqyrtohet si duhet (shih PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët* § 49, dhe *Laliq dhe të tjerët* § 32, përmendur më lart; krahaso GJEDNJ (Dhoma e Lartë), *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, vendimi i gjykatës, 8 korrik 2004, *KEDNJ*, 2004-VII, § 333; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mfudhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, vendimi i gjykatës, 2 mars 2010, § 171).

46. Paneli konsideron më tutje që UNMIK-u duhet të ndërmarrë hapa të duhur drejt kompensimit adekuat për ankuesin për dëmin jopasuror që e ka pësuar si rezultat i pezullimit të zgjatur të procedurave.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SA I PËRKET PAMUNDËSISË SË ANKUESIT QË TA KETË PADINË E TIJ TË ZGJIDHUR NGA GJYKATAT;

2. KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË BËHET SHQYRTIMI I ANKESËS SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SA I PËRKET KOHËZGJATJES SË PROCEDURAVE;

3. REKOMANDON QË UNMIK-u:

a. TË KËRKOJË NGA AUTORITETET KOMPETENTE NË KOSOVË QË T'I NDËRMARRIN TË GJITHË HAPAT E MUNDSHËM PËR TË SIGURUAR QË DO TË MERRET VENDIM PËR RASTIN E ANKUESIT PA ASNJË VONESË TË MËTEJME;

b. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT PËR ANKUESIN PËR DËMIN JOPASUROR;

c. TË NDËRMARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT, DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.

Andrey ANTONOV Zyrtar ekzekutiv	Marek NOWICKI Kryesues